

VENDIM
Nr. 178, datë 3.9.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS, LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SHA, PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKËS) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, germa “b”, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.9.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1774/1 prot., datë 2.9.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Ayen AS Energji’ sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekës) të aseteve të paluajtshme të saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen AS Energji” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Ura e Fanit”, “Fangu” dhe “Peshqesh”, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.3.2015, të ndryshuar, me vendimin e Bordit nr. 128, datë 16.8.2017.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1174 prot., datë 19.8.2024, ajo ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj, për të garantuar përmbushjen e detyrimit kundrejt marrëveshjes së kredisë sindikale, të nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., “OTP Bank” sh.a., “Intesa SanPaolo Bank” sh.a. dhe “Tirana Bank” sh.a., ku agent i kredisë dhe i kolateralit është zgjedhur “Raiffeisen Bank” sh.a.

- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë, në zbatim të nenit 7, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se në këtë aplikim nevojitet të plotësohet dhe sa më poshtë:

Neni 7, “Përmbajtja e kërkesës për transferim”

Pika 1: Një përshkrim i të licencuarit që përmban informacion mbi:

- germën “c”: shoqëria duhet të bëjë me dije efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;

- germën “d”: shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores, në lidhje me përshkrimin e kandidatit të propozuar për transferimin e aseteve;

- germën “e”: shoqëria duhet të japë informacion mbi mënyrën se si parashikon të garantojë shlyerjen e refinancimit dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të licencuar;

- germën “f”: shoqëria duhet të japë informacion për efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit;

- germën “g”: shoqëria duhet të japë informacion për efektin në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar;

- germën “h”: shoqëria duhet të depozitojë në ERE listën e aseteve fikse që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, me vlerën e secilit aset dhe vlerën totale të tyre, listë e cila duhet të jetë pjesë integrale e marrëveshjes së hipotekës, si dhe të sqarojë pozicionin e bashkëkredimarrësit në marrëveshjen e kredisë. Po ashtu, duhet të depozitojë marrëveshjen e kredisë sindikale dhe atë të hipotekës në format original ose fotokopje të njësuar me origjinalin;

- germën “j”: shoqëria duhet të informojë nëse ka pasur më herët transferime të aseteve fikse që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar;
 - Pika 3: shoqëria duhet të depozitojë korrespondencën e zhvilluar me MIE-n në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin;
 - Pika 6: shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë në ERE që kërkon të mos jetë e hapur për publikun.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj, për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj marrëveshjes së kredisë sindikale, të nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., “OTP Bank” sh.a., “Intesa SanPaolo Bank” sh.a. dhe “Tirana Bank” sh.a., ku agjent i kredisë dhe i kolateralit është “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Ayen AS Energji” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti